



Nr.13. Zyrtar -2023

Dt. 06/11/2023

Bazuar në vendimin nr.1427 të datës 30.04.2019 të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për themelimin e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi”, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

## KONKURS PËR KRIJIMTARI LETRARE (Për të rritur)

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, me synim të nxitjes së krijimtarisë letrare-artistike, fton krijuesit që të konkurrojnë me punimet e tyre letrare – artistike për çmimin letrar vjetor “Sulejman Krasniqi”, që ndahet në kuadër të shënimit të Ditës së Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”.

Vlerësimi bëhet nga njohës të fushës, ( juria profesionale), që formohet nga organet drejtuese të Komunës së Rahovecit, që do të bëjë përzgjedhjen e krijimeve më të mira letrare.

- ◆ Fituesit e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi” shpërblehen me shuma të caktuara monetare, ndërsa rezultatet e konkursit publikohen më 7 dhjetor 2023, me rastin e Ditës së Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec.
- ◆ Për të gjithë pjesëmarrësit në këtë konkurs, komuna e Rahovecit do të ndajë mirënjohje me qëllim të pasurimit të kulturës me krijimtari letrare. Konkursi ka për qëllim që të nxisë krijuesit që të merren me poezi dhe krijimtari letrare në prozë.
- ☐ Krijimi letrar (prozë apo poezi) nuk preferohet të jetë më i gjatë se 4 faqe A4.
- ☐ Punimet dorëzohen në kopje fizike (tri kopje) në zarf të myllur dhe me shifër (kod) në objektin e komunës së Rahovecit Rr. Dëshmorët e Pashtrikut p.n, sporteli Nr. 7
- ☐ Afati për dorëzimin e punimeve do të jetë nga 07 nëntor 2023 deri më 25 nëntor 2023.
- ☐ Përshkrimi: Për Çmimin letrar “Sulejman Krasniqi”.

Rahovec, nëntor 2023

